

**Drejtuar:**  
**KËSHILLIT MËSIMOR – SHKENCOR TË**  
**FAKULTETIT TË KULTURËS FIZIKE**

**R E F E R A T**

*Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).*

Në bazë të nenit 1 të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr. 19-19/1 të datës 23.02.2023 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike nga mbledhja e mbajtur më 23.02.2023, në përbërje:

1. **Prof. Dr. Vullnet Ameti** – kryetar, Profesor ordinar, Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.
2. **Prof. Dr. Fadil Nika** – anëtar, Profesor ordinar, Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.
3. **Prof. Dr. Fadil Rexhepi** – anëtar, Profesor ordinar, Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.

në lidhje me Konkursin për zgjedhje - rizgjedhje të shpallur me datën 07.02.2023 në gazetën “Koha” dhe “Sloboden Pecat” si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (<https://unite.edu.mk/konkurs-per-zgjedhje-rizgjedhje-60/>) për zgjedhje - rizgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), komisioni recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim, konstatoi se:

Në konkursin në fjalë është paraqitur vetëm një (1) kandidat, Dr. Sc.Haki Ismaili, Profesor inordinar në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, Tetovë dhe i ka dorëzuar të gjitha dokumentacionet e nevojshme sipas konkursit, dhe atë:

- Thirrje mësimore - shkencore, me Vendim të organit kompetent, profesor inordinar
- Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magistraturës

- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse (listën e lëndëve të ligjëruar nëpër semestrat nga viti 2018 deri në vitin 2023)
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara (pjesëmarrja në konferenca)
- Kopje të punimeve shkencore të publikuara
- Kopje të punimeve të konferencave (book of abstract)
- Çertifikatatë për pjesëmarrje në konferenca
- Biografi e shkurtër
- Punimin e doktoratës - kopje
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj
- **Kopjet e vendimeve për anëtarë komisionesh në Universitetin e Tetovës**
- Çertifikatë nga libri amë i të lindurve
- Çertifikatë e shtetësisë

andaj komisioni recenzues ka nderin dhe kënaqësinë të paraqes këtë:

## **R A P O R T**

**Kandidati:** HAKI Safet ISMAILI

**Institucioni:** Fakulteti i Kulturës Fizike

**Fusha shkencore:** Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

## I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidati **Haki Ismaili** është i lindur më 01.01.1972 në Reçicë të Madhe. Arsimin fillor ka mbaruar në sh. f. “Përparimi” ndërsa arsimin e mesëm në Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë në drejtimin e përgjithshëm.

Studimet deridiplomike i ka përfunduar në vitin 1994 në Institutin e Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi” Tiranë, Shqipëri dhe ka fituar titullin **Profesor i diplomuar i edukimit fizik dhe shëndetësor**. Gjatë kohës së studimeve, tregoi rezultate të shkëlqyera si në lëndët teorike ashtu edhe në ato praktike. Në vitin 1996/97 ka qenë i angazhuar si arsimtar i edukats fizike në shkollën fillore “Përparimi”, R. e Madhe Tetovë, ndërkaq më pas në vitin 1997/98 u punësua si arsimtar i edukatës fizike në shkollën fillore “Dervish Cara”, Fsh. Pallçisht Tetovë. Gjatë periudhës 1996/2002 u punësua si asistent i ri në USHT kryesisht në Fakultetin e Kulturës Fizike- Tetovë.

Gjatë viteve 1997 dhe 2010 ushtron detyrën e profesorit të edukimit fizik në shkollën e mesme “Mosha Pijade,, Tetovë.

Në vitin 2004 -Asistent në USHT, Fakulteti i Kultures Fizike- Tetovë. Në lëndët: Psikomotorikë dhe Futboll.

Nga viti 2011 e deri më 2018 kryen funksionin e prodekanit për arsim në këtë fakultet dhe ka pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme promovuese të fakultetit.

Në periudhën 2018-2022 ka ushtruar detyrën e Dekanit të Fakultetit të Kulturës Fizike.

Gjatë periudhës 1989-94 ka qenë futbollist aktiv në K.F “Reçica,,-Tetovë,kurse në vitet 1990/96 ka qënë sportist aktiv në sportet luftarake: “YOSE-IKANBUDO” ku dhe në vitin 1995 më datë 3 deri në 6 maj merr pjesë si reprezentues në kampionatin botëror në “YOSE-IKANBUDO”, në Brig, Zvicër.

Në vitet 2016-2020 ushtron detyrën si kryetar i klubit të volejbollit për femra të U.T dhe poashtu gjatë viteve 2018-2020 ushtron po detyrën e njëjtë tek klubi i meshkujve U.T.

Nga viti 2011 ushtron detyrën si nënkryetar I klubit të futbollit KF.Reçica –Tetovë ku dhe vazhdon aktualisht.

Studimet e magjistraturës i ka kryer në akademinë e edukimit fizik dhe sporteve “Vojo Kushi” Tiranë, Shqipëri gjatë viteve 2001/03., me temë Ndikimi i programimit gjatë eksperimentimit në profilizimin sportiv tek nxënësit e shkollës së mesme 14-16vjeç, futboll.” dhe ka fituar titullin **Magjistër i edukimit fizik dhe sportit**.

Në periudhën 2010-2013 i përfundoi me sukses studimet e doktoraturës në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodij” Fakulteti I Kulturës Fizike-Shkup me temë “Утврдување на разликите во антропометриските Карактеристики, Моторичките и Специфично Фудбалските Моторички Способности кај младите Фудбалери од 12 до 14 години Р. Македонија.” dhe mori titullin **Doktor i shkencave në fushën e kineziologjisë**.

Në vitin 2013 u zgjodh në thirrjen mësimore-shkencore **docent** për lëndët: ***Futboll dhe Psikomotorikë.***

Ndërkaq në vitin 2018 u zgjodh në thirrjen mësimore-shkencore **inordinarë** për disiplinat lëndore të cituara në konkurs: ***Teoria dhe metodika e edukimit fizik I dhe II dhe Futboll.***

Kandidati është anëtar i bordit editorial të revistës shkencore “*Sport and health*” të Fakultetit të Kulturës Fizike për Vol.5 / No. 9-10 / (2018), Vol.6 / No. 11-12 / (2019), Vol.7 / No. 13-14 / (2020), Vol.8 / No. 15-16 / (2021), Vol.9 / No. 17-18 / (2022) dhe Vol.9 / No. 19-20 / (2022), gjithashtu është pjesë e këshillit organizues të Konferencave vjetore Ndërkombëtare Ballkanike të Shkencave Sportive: IBCSS2019 dhe IBCSS2022.

Ai gjithashtu ka qënë anëtar i këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare të shkencave sportive - ICSS2019-Tiranë,Shqipëri dhe anëtar i këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare të shkencave sportive - Kolegji AAB,Prishtinë,Kosovë

Përveç gjuhës amtare-shqipe, ai flet rrjedhshëm gjuhën maqedonase, si dhe ka njohuri të mira të gjuhës angleze,sërbe dhe slovene. Gjithashtu kandidati posedon aftësi të mira në përdorimin e kompjuterit dhe programeve të ndryshme si paketën Microsoft Office (Word, Excel, PowerPoint) si dhe posedon njohuri në përdorimin e sistemeve operative Windows dhe Mac OS. Ka aftësi shumë të mira komunikuese dhe organizative, vlerëson kualitetet e punës në ekip, është i aftë të ballafaqohet me afatet e fundit dhe për punë nën presion.

## **II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

### **A. Mbajtja e mësimit (ushtrime dhe ligjërata)**

Vitet e marrjes së titujve akademik, të kandidatit Haki Ismaili janë si vijon:

- Në vitin 2018 është zgjedhur në thirrjen ***profesor inordinar*** në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.
- Në vitin 2013 është zgjedhur në thirrjen ***docent***, në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.
- Gjatë periudhës 1996-2002 u angazhua si ***asistent i ri part time*** në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.

- Në vitin 2004 është i angazhuar si *asistent* në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.

Në vitin 1997/2010 ka qenë i punësiar si profesor i edukimit fizik në shkollën e mesme “Moshë Pijade,, Tetovë.

-

Pas zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore inordinar, kandidati gjatë viteve akademike të periudhës 2018-2023 në Fakultetin e Kulturës Fizike, veprimtarinë arsimore-mësimore e ka zhvilluar në mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve dhe konsultimeve në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, në këto lëndë mësimore:

### **Cikli i parë i studimeve:**

#### **Semestri Dimëror 2018:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Teoria dhe metodika e futbollit (1+1) – Ushtrime*

#### **Semestri Veror 2019:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Kontrrolli Motor (0+2) – Ushtrime*
- *Futbolli vogël (0+2) – Ushtrime*
- *Aktivitete Aventureske dhe Turizëm (0+2) – Ushtrime*
- *Edukim fizik special IV (0+2)-Ushtrime*

#### **Semestri Dimëror 2019:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Teoria dhe metodika e futbollit (1+1) – Ushtrime*

#### **Semestri Veror 2020:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Kontrrolli Motor (0+2) – Ushtrime*
- *Aktivitete Aventureske dhe Turizëm (0+2) – Ushtrime*
- *Edukim fizik special IV (0+2)-Ushtrime*

#### **Semestri Dimëror 2020:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Teoria dhe metodika e futbollit (1+1) – Ushtrime*
- *Edukim fizik special I (0+2)-Ushtrime*

**Semestri Veror 2021:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Aktivitete Aventureske dhe Turizëm (0+2) – Ushtrime*
- *Edukim fizik special IV (0+2)-Ushtrime*

**Semestri Dimëror 2021:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Edukim fizik special I (0+2)-Ushtrime*

**Semestri Veror 2022:**

- *Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Aktivitete Aventureske dhe Turizëm (0+2) – Ushtrime*
- *Edukim fizik special IV (0+2)-Ushtrime*

**Semestri Dimëror 2022:**

- *Teoria dhe metodika e aktivitetit fizik I (2+2)-Ligjerata dhe Ushtrime*
- *Teoria dhe metodika e futbollit (1+2) – Ushtrime*
- *Edukim fizik special I (0+2)-Ushtrime*

**Cikli i dytë i studimeve:**

**Semestri Dimëror 2018 :**

- *Teoria e lëvizjes (3+2) – Ligjerata*

**Semestri Veror 2019:**

- *Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik (2+2) – Ligjerata*

**Semestri Dimëror 2019**

- *Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)-Ligjerata(FTU)*

**Semestri Veror 2020:**

- *Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik (2+2) – Ligjerata*

**Semestri Dimëror 2020:**

- *Kineziologjia antropologjike (3+2) – Ligjerata*

- *Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)-Ligjerata(FTU)*

**Semestri Veror 2021:**

- *Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik (2+2) – Ligjerata*

**Semestri Dimëror 2021:**

- *Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1) – Ligjerata  
(Arkitektur,Ndërtimtari,Mekatronik)*

**Semestri Veror 2022:**

- *Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik (2+2) – Ligjerata*

**Semestri Dimëror 2022:**

- *Kineziologjia antropologjike (3+2) – Ligjerata*

**Cikli i tretë i studimeve:**

**Viti 2019:**

- *Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1) – Ligjerata*

**B. Dispensa interne për ligjërata dhe ushtrime**

- Haki Ismaili “*Kineziologjia Antropologjike*”
- Haki Ismaili “*Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik*”
- Haki Ismaili “*Aktiviteti sportiv dhe shëndeti*”

Prof. Dr. Haki Ismaili (profesor inordinar) ka qenë **mentor** i 25 temave të diplomës në ciklin e parë të studimeve dhe 40 herë ka qenë në rolin e **anëtarit** të komisionit për mbrojtjen e temës së diplomës në nivelin Bachelor. Kandidati gjithashtu ka qenë mentor e një teme të magjistraturës dhe **anëtar** i komisionit për vlerësim të gjithsej 15 temave të magjistraturës (master), si dhe 6 herë ka qenë **anëtar** komisioni për vlerësim dhe mbrojtjen publike të punimeve në ciklin e tretë të doktoraturës (PhD), pranë Fakultetit të Kulturës Fizike.

Kandidati është anëtar i këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike që nga marrja e titullit docent dhe më pas si profesor inordinar, kryetar i Komisionit për Provim Pranues dhe komisionit për Rangim të studentëve në Fakultetin e Kulturës Fizike në vitet 2018-2022, si dhe anëtar i komisionit për Akreditim të programeve studimore në ciklin e parë, të dytë dhe të

tretë si dhe anëtar i komisionit për Riakreditim në ciklin e parë. Njëkohësisht, ka qenë kryetar i Komisionit për Furnizime Publike në nivel të UT-së ku dhe vazhdon aktualisht.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore të mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. Dr.Haki Ismaili** ka realizuar gjithsej **87.54** pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

### III. VEPRIMTARIA KËRKIMORE - SHKENCORE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë vazhdimisht me realizimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore në fushën e sportit, që përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare në periudhën 2018-2023. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur si më poshtë:

#### A. Artikuj shkencorë

1. Metin Dalip, Kushtrim Abdullahu, Malsor Gjonbalaj, **Haki Ismaili**, Vullnet Ameti, Shpresa Memishi, “*Current methods of soccer match analysis in FC Shkendija Tetovo practical application of preparation in season on weekly microcycle via video and gps base of match analysis*” Sport and Health, ISSN: 1857-9310, UDC: 796.332.071.42:061.23]-028.23(497.751), Vol. 9, Nr. 17-18, pg. 157-167, 2022
2. **Ismaili, H.** Dalip, M., Saiti, B., Ajrush, L. (2022) “*Determination of the differences in the anthropometric characteristics, general motor, and specific motor ability on young n. Macedonian soccer players from U-12 to U-14 years old boys.*” Sport & Health, vol. 9 no. 17-18, pp.105-114,Tetova.
3. Iseni, A. Sallteku, A., Ademi, A., **Ismaili, H.** (2022). “*Correlation of body composition with agility and speed of students.*” Research in Kinesiology, vol. 50, no. 1, pp. 46-48, Ohrid.
4. Ameti, V. , Iseni, A., **Ismaili, H.**, Abazi, L. (2021). “*The impact of physical fitness and body composition on the success of sprint running at 400 meters.*” Activities in Physical Education and Sport, vol.11, no. 1-2. Pp. Ohrid.
5. Vullnet Ameti, Astrit Iseni, Shpresa Memishi, **Haki Ismaili**, “*The impact of some motor abilities upon the success of sprint running on 30 and 80 meters among 14-year-old*



*students*” Sport and Health, ISSN: 1857-9310, UDC: 796.422.12.012.11-057.874, Vol. 8, Nr. 15-16, pg. 82-91, 2021.

6. Vullnet Ameti, Astrit Iseni, Shpresa Memishi, **Haki Ismaili**, Blerim Sulejmani, “*The influence of specific-motor abilities on anthropometric characteristics in 13 year old students*” Sport and Health, ISSN: 1857-9310, UDC: 796.012.1.077.5:572.087.1 (497.721), Vol. 7, Nr. 13-14, pg. 57-70, 2020.

## **B. Konferenca Shkencore**

1. Metin Dalip, Eli Handziska, Zoran Handziski, Vullnet Ameti, Shpresa Memishi, **Haki Ismaili**, Lejla Ajrush, “*Following of training process over Creatine Kinase, Potassium and Anaerobic thresholds levels and performance testing indicators in professional football players after a preparation period of six weeks*” 2nd International Congress on Natural, Health Sciences and Technology – 7th International Balkan Conference in Sport Sciences, ISBN 978-608-217-101-2, 18-19 May 2022, Tetovo.
2. Metin Dalip, Kushtrim Abdullahi, Malsor Gjonbalaj, **Haki Ismaili**, Vullnet Ameti, Shpresa Memishi, “*Contemporary methods of soccer match analysis practical application of match preparation in elite north macedonian soccer club*” 2nd International Congress on Natural, Health Sciences and Technology – 7th International Balkan Conference in Sport Sciences, ISBN 978-608-217-101-2, 18-19 May 2022, Tetovo.
3. Dalip, M., Abdullahi, K., Gjonbalaj, M., **Ismaili, H.**, Ameti, V., Memishi, Sh. *Contemporary methods of soccer match analysis in Fc Shkendija Tetovo practical application of preparation in season on weekly microcycle via video and gps base of match analysis.* 7th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, 18-19 maj2022 tetovo.
4. **Ismaili, H.**, Dalip, M., Saiti, B., Ajrush, L. Determination of the differences in the anthropometric characteristics, general motor, and specific motor ability on young n. Macedonian soccer players from U-12 to U-14 years old boys. 7th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, 18-19 maj2022 tetovo.

5. Sulejmani, B. **Ismaili, H.**, Ademi, A., Iseni, A. (2022). The Influence of anthropometric characteristics and speed on long jump performance. XIV International Scientific Conference modern trends of physical education and sports, 7-8 October, Abstract book, pp. 114, Sofia.
6. Vullnet Ameti, Astrit Iseni, Shpresa Memishi, **Haki Ismaili**, “Влијанието на некои моторни способности врз успешноста на спринтерското трчање на 30 и 80 метри кај ученици на возраст од 14 години”, 25th Symposium for Sport and Physical Education of Youth and 17th International Scientific Conference, Federation of Sport Pedagogues of Macedonia and Sofia University “St. Kliment Ohridski”, 15-16 April 2022, Ohrid.
7. Rexhepi, F., **Ismaili, H.**, Gashi, B. (2021). “Përcaktimi I momentit të forcës në kyçe gjatë performimit të teknikës bench press me sforcim maksimal” International Conference in Sports Sciences, 10-11 December, Abstract book, Kolegji AAB, Prishtina.pp27
8. Ameti, V., Iseni, A., Memishi, Sh., **Ismaili, H.** (2020). “The influence of specific-motor abilities on anthropometric characteristics az 13 year old students”. 17th Annual Scientific Conference of Montenegrin Sport Academy “Sport, Physical Activity and Health: Contemporaraz Perspectives”: Cavtat Dubrovnik, Croatia, 2-5 April, Abstract book – Monten, J. Sports . Sci.Med. vol. 1, supp.1, pp.1.33.
9. Iseni, A., Asllani, I. Sulejmani, B. **Ismaili, H.** (2019). “The effect of motoric skills in the success of sprint running”. 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 15-17 May, Abstract Book, pp. 105, Tetova.
10. Iseni, A., Asllani, I. Sulejmani, B. **Ismaili, H.** (2019). “The effect of motoric skills in the success of sprint running.” 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 15-17 May, Abstract Book, pp. 105, Tetova.
11. Rexhepi, Y., Shaqiri, K., Ademi, A., **Ismaili, H.**, Sulejmani, B. (2019) “Differences in the anthropometric dimensions between karate and non athletes at the age of 16-18 years” 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 15-17 May, Abstract Book, pp. 100, Tetova.

12. Mamuti, F., **Ismaili, H.** (2019). “*Globalization and needs for reforms in the higher education in the Republik of North Macedonia*”, International Conference in Sport Science, ISCC, pp. 12, Abstract Book, Tirana.
13. **Ismaili, H.** (2019). 2nd scientific conference for physical education, sport and health, 1-2 November, Faculty of Physical Education and Sport, Prishtina.
14. Dalip, M., **Ismaili, H.**, Memishi, SH. “*The physiological effects of soccer training in elite Macedonian youth soccer players*”. 5th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, (IBCSS201 6) pp.84, 18-19 maj 2018 Tetovo.
15. Turjaka, A., **Ismaili, H.**, Shaqiri, D., Memishi, SH. Physical activities and health 5th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, (IBCSS201 6) pp.30, 18-19 maj 2018 Tetovo.
16. Ameti, V., **Ismaili, H.**, Memishi, Sh., Shaqiri, K. “*Impact of some specific and basic motor skills in football among students aged 14-16 years.*” 5th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, (IBCSS201 6) pp.11, 18-19 maj 2018 Tetovo.
17. **Ismaili, H.** (2018). World Congress of Performance Analysis of Sport XII, Opatija-Croatia, September 19-23, 2018.

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues e vlerësoi veprimtarinë kërkimore - shkencore në periudhën paraprake, e cila është me rëndësi thelbësore për vlerësimin e kandidatit.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore të mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. Dr. Haki Ismaili** ka realizuar gjithsej **47,0** pikë nga veprimtaria kërkimore-shkencore.

#### IV. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË

- Nga viti 2018 deri më 2022 ka ushtruar postin e Dekanit të Fakultetit të Kulturës Fizike.
- Nga viti 2011 e deri më 2018 kryen funksionin e prodekanit për arsim në Fakultetin e Kulturës Fizike.
- Anëtar i bordit editorial të revistës shkencore “Sport and Health” në numrat vijues:
  - Vol.5 / No. 9-10 / (2018)
  - Vol.6 / No. 11-12 / (2019)
  - Vol.7 / No. 13-14 / (2020)
  - Vol.8 / No. 15-16 / (2021)
  - Vol.9 / No. 17-18 / (2022)
  - Vol.9 / No. 19-20 / (2022)
- Pjesë e këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare ballkanike të shkencave sportive - IBCSS2018,IBCSS2019 dhe IBCSS2022.
- Pjesë e këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare të shkencave sportive - ICSS2019-Tiranë,Shqipëri.
- Pjesë e këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare të shkencave sportive – Kolegji AAB,Prishtinë,Kosovë
  
- Kryetar i komisionit për rangimin e studentëve të pranuar në Fakultetin e Kulturës Fizike.
- Kryetar i komisionit për provim pranues të studentëve në Fakultetin e Kulturës Fizike.
- Anëtar i komisionit për Akreditim të programeve studimore në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë.
- Anëtar i komisionit për Riakreditim të programeve studimore në ciklin e parë të studimeve.
- Kryetar e Komisionit për Furnizime Publike në nivel të UT-së.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore të mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. Dr.Haki Ismaili**. ka realizuar gjithsej **29.0** pikë nga veprimtaria me interes më të gjerë.

#### IV. VEPRIMTARITË SPORTIVE

- Sportist aktiv në sportet luftarake: “YOSE-IKANBUDO”
- Pjesëmarës aktiv si reprezentues në kampionatin botëror në “YOSE-IKANBUDO”, në Brig, Zvicër
- Futbollist aktiv në K.F “Reçica,,-Tetovë..
- Kryetar i klubit të volejbollit “Universiteti i Tetovës” – Meshkuj.
- Kryetar i klubit të volejbollit “Universiteti i Tetovës” – Femra.
- Nënkryetar i klubit të futbollit KF.Reçica –Tetovë.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore të mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati ka realizuar gjithsej **5.0** pikë nga veprimtaria sportive.

## PËRFUNDIM DHE PROPOZIM - VENDIM

Nga gjithë e thëna më sipër, mund të shihet qartë vija e lartë e ngritjes të zhvillimit profesional të kandidatit **Prof. Dr. Haki Ismaili** (profesor inordinar), si në veprimtarinë edukative- mësimore, veprimtarinë kërkimore - shkencore, veprimtarinë profesionale - artistike dhe sportive, si dhe veprimtarinë me interes më të gjërë, është e qartë se kandidati që nga zgjedhja e tij në thirrjen profesor inordinar tregon aktivitet të gjerë mësimor në disiplina për të cilat ai konkurren. Nuk është i paktë edhe angazhimi i tij në organizimin e tubimeve shkencore në universitet, si dhe më gjerë.

Komisioni recensues, konstaton se kandidati **Prof. Dr. Haki Ismaili** (profesor inordinar), i plotëson kriteret e specifikuar për zgjedhje në thirrjen mësimore - shkencore **Profesor ordinar**, sipas Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore - shkencore, shkencore, mësimore- profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, përkatësisht Ligjit për Arsimin e Lartë të RMV, pasi që ka realizuar **87.54** pikë nga veprimtaria edukative-mësimore, **47.0** pikë nga veprimtaria kërkimore-shkencore, **5.0** pikë nga veprimtaria sportive dhe aplikative dhe **29.0** pikë nga veprimtari me interes më të gjerë, gjithsejt **168.0** pikë.

Bazuar në të dhënat e më sipërme, kemi nderin dhe kënaqësinë që Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, t'i propozojmë që kandidati **Prof. Dr. Haki Ismaili** i cili i plotëson të gjitha dispozitat ligjore, të zgjidhet **PROFESOR ORDINAR** në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, në lëmin Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, 02.03.2023

**KOMISIONI RECENSUES:**

\_\_\_\_\_  
**Prof. Dr. Vullnet Ameti – kryetar, profesor ordinar**

\_\_\_\_\_  
**Prof. Dr. Fadil Nika – anëtar, profesor ordinar**

\_\_\_\_\_  
**Prof. Dr. Fadil Rexhepi – anëtar, profesor ordinar**

## FORMULARI 1

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE - SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE - PROFESIONALE

Kandidati: **Prof. Dr. Haki Safet ISMAILI**

Institucioni: **Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës**

Lëmi shkencorë: **Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).**

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1.	<p>Nota mesatare të paktën 8.00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veç e veç, dmth. ka arritur një sukses mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) të studimeve të integruara të ciklit të parë dhe të dytë *</p> <p>Nota mesatare në ciklin e parë të studimeve: <u>8.00</u>                      Nota mesatare në ciklin e dytë të studimeve: <u>8.00</u>                      Nota mesatare në studimet e integruara: _____</p>	Po
2.	<p>Grada shkencore - Doktor i Shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet</p> <p>Lëmi shkencorë <u>50401-Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër)</u>, fusha <u>504-Kineziologji</u>, sfera <u>5-Shkencat shoqërore</u>.</p>	Po
3.	<p>Të paktën katër punime shkencore** të publikuara në botim shkencor referues në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje.</p>	Po
	<p>Revistë shkencore e recensuar që është e indeksuar në të paktën një bazë të dhënash në internet, të tilla si Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago, Journal Rank ose një bazë tjetër të dhënash të revistave që do të ta përcaktojë Këshilli</p>	Po

\*\* Për kandidatin/ët që kanë më shumë se 4 (katër) punime shkencore në një botim shkencor referues, komisioni recensues punimet shkencore do ti listojë, notoj dhe vlerësojë ato në Formularin 2.

3.1	<p>Kombëtar i Arsimit të Lartë</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <u>Sport and Health</u></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të të dhënave të revistës: <u>SCOPUS I.F. 11.928 (2021)</u></p> <p>3. Emri i punimit: <u>“Determination of the differences in the anthropometric characteristics, general motor, and specific motor ability on young n. Macedonian soccer players from U-12 to U-14 years old boys.”</u></p> <p>4. Data e publikimit: <u>2022</u></p>	Po
3.2	<p>Një revistë shkencore në të cilën punimet e botuara janë të recensuara dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende, dhe numri i anëtarëve nga një vend nuk mund të kalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <u>Sport and Health</u></p> <p>2. Bordi Redaktues Ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendit): <u>37- numri i përgjithshëm, 11 vende: Albania, USA, North Macedonia, Turkey, Bosna Hercegovina, Germany, Montenegro, Kosovo, Bulgaria, Croatia, Serbia.</u></p> <p>3. Emri i punimit: <u>“The impact of some motor abilities upon the success of sprint running on 30 and 80 meters among 14-year-old students” -Tetovo</u></p> <p>4. Data e publikimit: <u>2021</u></p>	Po
3.3	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet e publikuara janë të recensuara dhe që publikohet në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe/ose OBZhE.</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <u>Sport, Physical Activity and Health</u></p> <p>2. Emri i anëtarit të BE/OBZhE: <u>Croatia</u></p> <p>3. Emri i punimit: <u>“The influence of specific-motor abilities on anthropometric characteristics az 13 year old students”.</u></p> <p>4. Data e publikimit: <u>2020</u></p>	Po



3.4	<p>Përmbledhje e punimeve shkencore të recensuara, të prezentuara në konferenca akademike ndërkombëtare ku anëtarët e bordit shkencor janë nga të paktën tre vende.</p> <p>1. Emri i përmbledhjes: <u>Conference Book ISBN 978-608-217-078-7</u>  2. Emri i konferencës ndërkombëtare: <u>6th International Balkan Conference in Sport Sciences</u>  3. Emrat e vendeve: <u>North Macedonia, Turkey, USA</u>  4. Emri i punimit: <u>Differences in the anthropometric dimensions between karate and non athletes at the age of 16-18 years”</u>  5. Data e publikimit: <u>15-17 May 2019, Tetovo</u></p>	Po
4.	<p>Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, dmth. një shkollë e lartë profesionale e pavarur.</p> <p>Gjuha e huaj: <u>Angleze</u>  Emri i dokumentit: <u>Certificate</u>  Publikuesi i dokumentit: <u>Universiteti Tiranës, Fakulteti i gjuhëve të huaj, Tiranë.</u>  Data e lëshimit të dokumentit: <u>06.12.2003</u></p>	Po
5.	<p><b>Ka aftësi për të kryer veprimtari të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit në të cilin janë fituar aftësitë për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë.  <u>Universiteti i Tetovës</u></p> <p>2. Lloji i trajnimit / përvojës / arsimimit për përvetësimin e aftësive për të kryer veprimtari të arsimit të lartë  <u>Mësimdhënie</u></p> <p>3. Periudha e përvetësimit të aftësive për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë  <u>1994-2023</u></p>	Po

## FORMULARI 2

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE - SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE - PROFESIONALE

Kandidati: **Prof. Dr. Haki Safet ISMAILI**

Institucioni: **Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës**

Lëmi shkencorë: **Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).**

#### I. VEPRIMTARIA ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë të studimeve)</b>	<b>1.8</b>
1.1	<i>Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3) 4 semestra</i>	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
1.2	<i>Teoria dhe metodika e futbollit (1+2) 1 semestër</i>	$1 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 0.6$
1.3	<i>Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3) 4 semestra</i>	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
1.4	<i>Teoria dhe metodika e aktivitetit fizik I (2+2) 1 semestër</i>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
<b>2.</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve (lëndët në ciklin e parë të studimeve)</b>	<b>16.20</b>
2.1	<i>Teoria dhe metodika e futbollit (1+1) 3 Semestra</i>	$1 \times 15 \times 3 \times 0.03 = 1.35$
2.2	<i>Teoria dhe metodika e futbollit (1+2) 1 semestër</i>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
2.3	<i>Kontrolli Motor (0+2) 2 semestra</i>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
2.4	<i>Aktivitete Aventureske dhe Turizëm (0+2) 4 semestra</i>	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
2.5	<i>Futbolli vogël (0+2) 1 semestër</i>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
2.6	<i>Edukim fizik special IV (0+2) 4 semestra</i>	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
2.7	<i>Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3) 4 semestra</i>	$3 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 5.4$
2.8	<i>Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3) 4 semestra</i>	$3 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 5.4$
2.9	<i>Psikomotorik (0+2) 3 semestra</i>	$2 \times 15 \times 3 \times 0.03 = 2.7$
2.10	<i>Teoria dhe metodika e aktivitetit fizik I (2+2) 1 semestër</i>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
<b>3.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve)</b>	<b>6.0</b>
3.1	<i>Teoria e lëvizjes (3+2) 1 semestër</i>	$3 \times 15 \times 1 \times 0.05 = 2.25$
3.2	<i>Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik (2+2) 4 semestra</i>	$2 \times 15 \times 4 \times 0.05 = 6$
3.3	<i>Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)(FTU) 2 semestra</i>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.05 = 3$
3.4	<i>Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)( Arkitektur, Ndërtimtari, Mekatronik) 1 semestër</i>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.05 = 0.9$
3.5	<i>Kineziologjia antropologjike (3+2) 2 semestra</i>	$3 \times 15 \times 2 \times 0.05 = 4.5$

4	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e tretë të studimeve)</b>	
4.1	<i>Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1), 1 semestër</i>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.05 = 1,5$
<b>5.</b>	<b>Konsultimet me studentë</b>	<b>1.58</b>
5.1	<i>Teoria dhe metodika e edukimit fizik I (2+3) 4 semestra 25 student</i>	$25 \times 4 \times 0.002 = 0.20$
5.2	<i>Teoria dhe metodika e edukimit fizik II (2+3) 4 semestra 20 student</i>	$20 \times 4 \times 0.002 = 0.16$
5.3	<i>Teoria dhe metodika e futbollit (1+1) 3 Semestra 20 student</i>	$20 \times 3 \times 0.002 = 0.12$
5.4	<i>Teoria dhe metodika e futbollit (1+2) 1 semestër 15 student</i>	$15 \times 1 \times 0.002 = 0.03$
5.5	<i>Kontrulli Motor (0+2) 2 semestra 30 student</i>	$30 \times 2 \times 0.002 = 0.12$
5.6	<i>Aktivitete Aventureske dhe Turizëm (0+2) 4 semestra 25 student</i>	$25 \times 4 \times 0.002 = 0.20$
5.7	<i>Futbolli vogël (0+2) 1 semestër 25 student</i>	$25 \times 1 \times 0.002 = 0.05$
5.8	<i>Edukim fizik special IV (0+2) 4 semestra 30 student</i>	$30 \times 4 \times 0.002 = 0.24$
5.9	<i>Psikomotorik (0+2) 3 semestra 45 student</i>	$45 \times 3 \times 0.002 = 0.27$
5.10	<i>Teoria dhe metodika e aktivitetit fizik I(2+2) 1 semestër 20 student</i>	$8 \times 1 \times 0.002 = 0.04$
5.11	<i>Teoria e lëvizjes (3+2) 1 semestër 8 student</i>	$8 \times 1 \times 0.002 = 0.016$
5.12	<i>Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik (2+2) 4 semestra 8 student</i>	$8 \times 4 \times 0.002 = 0.064$
5.13	<i>Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)(FTU) 2 semestra 8 student</i>	$8 \times 2 \times 0.002 = 0.32$
5.14	<i>Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)( Arkitektur, Ndërtimtari, Mekatronik) 1 semestër 25 student</i>	$25 \times 1 \times 0.002 = 0.05$
5.15	<i>Kineziologjia antropologjike (3+2) 2 semestra 13 student</i>	$13 \times 2 \times 0.002 = 0.052$
5.16	<i>Aktiviteti sportiv dhe shëndeti (2+1)(Cikli i tretë) 1 semestër 6 studentë</i>	$6 \times 1 \times 0.002 = 0,012$
<b>6</b>	<b>Dispensa interne për ligjërata/ushtrime</b>	<b>8.0</b>
6.1	Haki Ismaili “Kineziologjia Antropologjike”	4.0
6.2	Haki Ismaili “Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik”	4.0
6.3	Haki Ismaili “Aktiviteti sportiv dhe shëndeti”	4.0
<b>7</b>	<b>Komisione për mbrojtje të temës së diplomës</b>	<b>7.3</b>
7.1	Mentor i temës së diplomës, 25 studentë	$25 \times 0.2 = 5$
7.2	Anëtar i komisionit për mbrojtje të temës së diplomës, 40 studentë	$40 \times 0.1 = 4$
7.3	Mentor i temës magistraturës, 1 student	$1 \times 1,0 = 1$
7.4	Anëtar i komisionit për mbrojtje të temës së magistraturës, 15 studentë	$15 \times 0.3 = 4,5$
7.5	Anëtar i komisionit për mbrojtje të temës së doktoraturës, 6 studentë	$6 \times 0.5 = 3$
	<b>Gjithsej</b>	<b>87.54</b>

## II. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale të publikuara ne revistë të njohur shkencore/profesionale ndërkombëtare</b>	<b>101.40</b>
1.1	Metin Dalip, Kushtrim Abdullahu, Malsor Gjonbalaj, <b>Haki Ismaili</b> , Vullnet Ameti, Shpresa Memishi, “ <i>Current methods of soccer match analysis in FC Shkendija Tetovo practical application of preparation in season on weekly microcycle via video and gps base of match analysis</i> ” Sport and Health, ISSN: 1857-9310, UDC: 796.332.071.42:061.23]-028.23(497.751), Vol. 9, Nr. 17-18, pg. 157-167, 2022.	5.0
1.2	<b>Ismaili, H.</b> Dalip, M., Saiti, B., Ajrush, L. (2022) “ <i>Determination of the differences in the anthropometric characteristics, general motor, and specific motor ability on young n. Macedonian soccer players from U-12 to U-14 years old boys.</i> ” Sport & Health, vol. 9 no. 17-18, pp.105-114,Tetova.	5.0
1.3	Iseni, A. Sallteku, A., Ademi, A., <b>Ismaili, H.</b> (2022). “ <i>Correlation of body composition with agility and speed of students.</i> ” Research in Kinesiology, vol. 50, no. 1, pp. 46-48, Ohrid.	5.0
1.4	Ameti, V. , Iseni, A., <b>Ismaili, H.</b> , Abazi, L. (2021). “ <i>The impact of physical fitness and body composition on the success of sprint running at 400 meters.</i> ” Activities in Physical Education and Sport, vol.11, no. 1-2. Pp. Ohrid.	5.0
1.5	Vullnet Ameti, Astrit Iseni, Shpresa Memishi, <b>Haki Ismaili</b> , “ <i>The impact of some motor abilities upon the success of sprint running on 30 and 80 meters among 14-year-old students</i> ” Sport and Health, ISSN: 1857-9310, UDC: 796.422.12.012.11-057.874, Vol. 8, Nr. 15-16, pg. 82-91, 2021.	5.0
1.6	Vullnet Ameti, Astrit Iseni, Shpresa Memishi, <b>Haki Ismaili</b> , Blerim Sulejmani, “ <i>The influence of specific-motor abilities on anthropometric characteristics in 13 year old students</i> ” Sport and Health, ISSN: 1857-9310, UDC: 796.012.1.077.5:572.087.1 (497.721), Vol. 7, Nr. 13-14, pg. 57-70, 2020.	5.0

<b>2</b>	<b>Pjesëmarrje në konferenca dhe simpoziume shkencore ndërkombëtare</b>	<b>8.0</b>
2.1	Metin Dalip, Eli Handziska, Zoran Handziski, Vullnet Ameti, Shpresa Memishi, <b>Haki Ismaili</b> , Lejla Ajrush, “ <i>Following of training process over Creatine Kinase, Potassium and Anaerobic thresholds levels and performance testing indicators in professional football players after a preparation period of six weeks</i> ” 2nd International Congress on Natural, Health Sciences and Technology – 7th International Balkan Conference in Sport Sciences, ISBN 978-608-217-101-2, 18-19 May 2022, Tetovo.	1.0
2.2	Metin Dalip, Kushtrim Abdullahi, Malsor Gjonbalaj, <b>Haki Ismaili</b> , Vullnet Ameti, Shpresa Memishi, “ <i>Contemporary methods of soccer match analysis practical application of match preparation in elite north macedonian soccer club</i> ” 2nd International Congress on Natural, Health Sciences and Technology – 7th International Balkan Conference in Sport Sciences, ISBN 978-608-217-101-2, 18-19 May 2022, Tetovo.	1.0
2.3	Dalip, M., Abdullahi, K., Gjonbalaj, M., <b>Ismaili, H.</b> , Ameti, V., Memishi, Sh. <i>Contemporary methods of soccer match analysis in Fc Shkendija Tetovo practical application of preparation in season on weekly microcycle via video and gps base of match analysis.</i> 7th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, 18-19 maj2022 tetovo.	1.0
2.4	<b>Ismaili, H.</b> , Dalip, M., Saiti, B., Ajrush, L. Determination of the differences in the anthropometric characteristics, general motor, and specific motor ability on young n. Macedonian soccer players from U-12 to U-14 years old boys. 7th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, 18-19 maj2022 tetovo.	1.0
2.5	Sulejmani, B. <b>Ismaili, H.</b> , Ademi, A., Iseni, A. (2022). The Influence of anthropometric characteristics and speed on long jump performance. XIV International Scientific Conference modern trends of phzysical education and sports, 7-8 October, Abstract book, pp. 114, Sofia.	1.0

2.6	Vullnet Ameti, Astrit Iseni, Shpresa Memishi, <b>Haki Ismaili</b> , “Влијанието на некои моторни способности врз успешноста на спринтерското трчање на 30 и 80 метри кај ученици на возраст од 14 години”, 25th Symposium for Sport and Physical Education of Youth and 17th International Scientific Conference, Federation of Sport Pedagogues of Macedonia and Sofia University “St. Kliment Ohridski”, 15-16 April 2022, Ohrid.	1.0
2.7	Rexhepi, F., <b>Ismaili, H.</b> , Gashi, B. (2021). “Përcaktimi I momentit të forcës në kyçe gjatë performimit të teknikës bench press me sforcim maksimal” International Conference in Sports Sciences, 10-11 December, Abstract book, Kolegji AAB, Prishtina.pp27	1.0
2.8	Ameti, V., Iseni, A., Memishi, Sh., <b>Ismaili, H.</b> (2020). “The influence of specific-motor abilities on anthropometric characteristics az 13 year old students”. 17th Annual Scientific Conference of Montenegrin Sport Academy “Sport, Physical Activity and Health: Contemporarz Perspecitves”: Cavtat Dubrovnik, Croatia, 2-5 April, Abstract book – Monten, J. Sports . Sci.Med. vol. 1, supp.1, pp.1.33.	1.0
2.9	Iseni, A., Asllani, I. Sulejmani, B. <b>Ismaili, H.</b> (2019). “The effect of motoric skills in the success of sprint running”. 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 15-17 May, Abstract Book, pp. 105, Tetova.	1.0
2.10	Iseni, A., Asllani, I. Sulejmani, B. <b>Ismaili, H.</b> (2019). “The effect of motoric skills in the success of sprint running.” 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 15-17 May, Abstract Book, pp. 105, Tetova.	1.0
2.11	Rexhepi, Y., Shaqiri, K., Ademi, A., <b>Ismaili,H.</b> , Sulejmani,B.(2019) “Differences in the anthropometric dimensions between karate and non athletes at the age of 16-18 years” 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 15-17 May, Abstract Book, pp. 100, Tetova.	1.0
2.12	Mamuti, F., <b>Ismaili, H.</b> (2019). “Globalization and needs for reforms in the higher education in the Republik of North Macedonia”, International Conference in Sport Science, ISCC, pp. 12, Abstract Book, Tirana.	1.0

2.13	<b>Ismaili, H.</b> (2019). 2nd scientific conference for physical education, sport and health, 1-2 November, Faculty of Physical Education and Sport, Prishtina.	1.0
2.14	Dalip, M., <b>Ismaili,H.</b> , Memishi,SH. “ <i>The physiological effects of soccer training in elite Macedonian youth soccer players</i> ”. 5th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, (IBCSS201 6) pp.84, 18-19 maj 2018 Tetovo.	1.0
2.15	Turjaka,A., <b>Ismaili,H.</b> , Shaqiri, D., Memishi, SH. Physical activities and health 5th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, (IBCSS201 6) pp.30, 18-19 maj 2018 Tetovo.	1.0
2.16	Ameti,V., <b>Ismaili,H.</b> , Memishi,Sh., Shaqiri,K.” <i>Impact of some specific and basic motor skills in football among students aged 14-16 years.</i> ” 5th International Balkan Conference in Sport Science Abstract book, (IBCSS201 6) pp.11,18-19 maj 2018 Tetovo.	1.0
2.17	<b>Ismaili, H.</b> (2018). World Congress of Performance Analysis of Sport XII, Opatija-Croatia, September 19-23, 2018.	1.0
	<b>Gjithsej</b>	<b>47</b>

### III. VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJËRË

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	<b>Anëtar i bordeve të revistave dhe konferencave shkencore</b>	<b>7.0</b>
1.1	Anëtar i bordit editorial të revistës shkencore ndërkombëtare “ <i>Sport and Health</i> ” Vol.5 / No. 9-10 / (2018), Vol.6 / No. 11-12 / (2019), Vol.7 / No. 13-14 / (2020), Vol.8 / No. 15-16 / (2021), Vol.9 / No. 17-18 / (2022) dhe Vol.9 / No. 19-20 / (2022).	5x1.0=5.0
1.2	Antar i bordit editorial në këshillit organizues të Konferencës së 6-të dhe të 7-të Ndërkombëtare Ballkanike të Shkencave Sportive-IBCSS2019 dhe IBCSS2022.	2x1.0=2.0
1.3	Antar i bordit editorial në këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare të shkencave sportive - ICSS2019-Tiranë,Shqipëri.	1x1.0=1.0

1.4	Pjesë e këshillit organizues të konferencave vjetore ndërkombëtare të shkencave sportive – Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë	1x1.0=1.0
<b>2.</b>	<b>Anëtar i komisioneve në nivel të Universitetit</b>	<b>17.0</b>
2.1	Kryetar i komisionit për rangimin e studentëve të pranuar në Fakultetin e Kulturës Fizike (2018-2022).	5x0.5=2.5
2.2	Kryetar i komisionit për provim pranues të studentëve në Fakultetin e Kulturës Fizike (2018-2022).	5x0.5=2.5
2.3	Anëtar i komisionit për Akreditim të programeve studimore në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë.	3.0
2.4	Anëtar i komisionit për Riakreditim të programeve studimore në ciklin e parë.	1.0
2.5	Kryetar i Komisionit për Furnizime Publike në nivel të UT-së.	1.0
<b>3.</b>	<b>Funksione në kuadër të fakultetit</b>	<b>10.0</b>
3.1	Dekan në Fakultetin të Kulturës Fizike (2018-2022 )	6.0
3.2	Prodekan për arsim në Fakultetin e Kulturës Fizike (2011-2018)	4.0
	<b>Gjithsej</b>	

#### IV. VEPRIMTARITË SPORTIVE

<b>4.</b>	<b>Veprimtari sportive</b>	<b>Pikët</b>
4.1	Sportist aktiv në sportet luftarake: “YOSE-IKANBUDO”	/
4.2	Pjesëmarës aktiv si reprezentues në kampionatin botëror në “YOSE-IKANBUDO”, në Brig, Zvicër	/
4.3	Futbollist aktiv në K.F “Reçica,-Tetovë..	/
4.4	Kryetar i klubit të volejbollit “Universiteti i Tetovës” – Meshkuj.	2.0
4.5	Kryetar i klubit të volejbollit “Universiteti i Tetovës” – Femra.	2.0
4.6	Nënkryetar i klubit të futbollit KF.Reçica –Tetovë.	1.0
	<b>Gjithsej</b>	<b>5.0</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE - ARSIMORE	<b>87.54</b>
VEPRIMTARIA KËRKIMORE – SHKENCORE	<b>47.0</b>
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJËRË	<b>29.0</b>
VEPRIMTARITË SPORTIVE	<b>5.0</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>168.54</b>



Tetovë, 27.02.2023

**KOMISIONI RECENSUES:**

**Prof. Dr. Vullnet Ameti – kryetar, profesor ordinar**

**Prof. Dr. Fadil Nika – anëtar, profesor ordinar**

**Prof. Dr. Fadil Rexhepi – anëtar, profesor ordinar**

**Drejtuar:**  
**KËSHILLIT MËSIMOR – SHKENCOR TË**  
**FAKULTETIT TË KULTURËS FIZIKE**

**R E F E R A T**

*Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).*

Në bazë të nenit 1 të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr. 19-19/1 të datës 23.02.2023 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike nga mbledhja e mbajtur më 23.02.2023, në përbërje:

1. **Prof. Dr. Vullnet Ameti** – kryetar, Profesor ordinar, Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.
2. **Prof. Dr. Fadil Nika** – anëtar, Profesor ordinar, Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.
3. **Prof. Dr. Fadil Rexhepi** – anëtar, Profesor ordinar, Fakulteti i Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës.

në lidhje me Konkursin për zgjedhje - rizgjedhje të shpallur me datën 07.02.2023 në gazetën “Koha” dhe “Sloboden Pecat” si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (<https://unite.edu.mk/konkurs-per-zgjedhje-rizgjedhje-60/>) për zgjedhje - rizgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), komisioni recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim, konstatoi se:

Në konkursin në fjalë është paraqitur vetëm një (1) kandidat, Dr. Sc. Shpresa MEMISHI, Profesor inordinar në Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, Tetovë dhe i ka dorëzuar të gjitha dokumentacionet e nevojshme sipas konkursit, dhe atë:

- Thirrje mësimore - shkencore, me Vendim të organit kompetent, profesor inordinar
- Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magistraturës

- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse (listën e lëndëve të ligjëruar nëpër semestat nga viti 2018 deri në vitin 2023)
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara (pjesëmarrja në konferenca)
- Kopje të punimeve shkencore të publikuara
- Kopje të punimeve të konferencave (book of abstract)
- Çertifikatatë për pjesëmarrje në konferenca
- Biografi e shkurtër
- Punimin e doktoratës - kopje
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj
- Kopjet e vendimeve për anëtarë komisionesh në Universitetin e Tetovës
- Çertifikatë nga libri amë i të lindurve
- Çertifikatë e shtetësisë

andaj komisioni recenzues ka nderin dhe kënaqësinë të paraqes këtë:

## **R A P O R T**

**Kandidati:** SHPRESA Servet MEMISHI

**Institucioni:** Fakulteti i Kulturës Fizike

**Fusha shkencore:** Kineziologjia e zbatuar (sport, edukim fizik, rekreacion, kinezioterapi, tjetër), (50401 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

## I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidatja Shpresa Memishi është e lindur më 09.11.1982 në Tetovë. Arsimin fillor ka mbaruar në sh. f. "Naim Frashëri" ndërsa arsimin e mesëm në Gjimnazin "Kiril Pejçinoviç" në Tetovë në drejtimin e përgjithshëm.

